

DREJTORIA E RAJONIT JUGOR GJIROKASTER
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 03.09.2018

Për: „*Agbes Konstruksion*“ sh.p.k. Fier, Sheq i Madh.

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur, sherbime.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF – 73757 – 06 – 06 – 2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “ Mirembajtje rutine e dimerore me performance rruga Berat – Gllave – Antene + rruga Poshnje – Velmisht – K/Patos + rruga Corovode - Hambull + rruga Kozare – K/Kucove + rruga K/Marinez - Marinez 88.7km“, per nje periudhe 2-vjecare me fond limit 32 819 247 leke pa tvsh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 11.06.2018 nr. 23.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit : çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Caushi” shpk NIPT J97511807W
Vlera 23032360 (njetzet e tre milion e tridhjetë e dy mijë e treqind e gjashtedhjetë) leke pa tvsh
(me numra dhe fjalë)

2. “Beqiri” shpk shpk NIPT-J 98624801V,
Vlera 25102744 (Njetzet e pesë milion e njëqind e dy mijë e shtatëqind e dyzet e katër) leke pa tvsh.

3. “Sterkaj” shpk NIPT – J68310708M
Vlera : 29362860 (njetzet e nente milion e treqind e gjashtedhjetë e dy mijë e teteqind e gjashtedhjetë) leke pa tvsh

4. “Vagalat” shpk & “Curri” shpk NIPT J679027185S
Vlera : 31396090 (tridhjetë e një milion e treqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e nentëdhjetë) leke pa tvsh

5. “Alfa 2” shpk & “Spektri” shpk NIPT K 82612003J
Vlera : 31819850 (tridhjetë e një milion e teteqind e nentëmbëdhjetë mijë e teteqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh

6. “Company Riviera 2008” shpk NIPT:K81716011V
Vlera 32607590 (tridhjetë e dy milion gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind e nentëdhjetë) leke pa tvsh

7. “Agbes Konstruksion” shpk NIPT: K32807432W
Vlera: 29 414 987.2 (njetzet e nente milion e katërqind e katërmëdhjetë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e shtatë. pik dy) leke pa tvsh

8. “Shendelli” shpk (pa oferte) NIPT: K07924803N

9.” Grand Konstruksion” shpk (pa oferte)

NIPT:L38109801T

10.Adem Pojani (pa oferte)

NIPT : K51524013W

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Caushi shpk”,

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Sipas vertetimit të paraqitur nr. T00389453, date 27.06.2018, ora 22.02, rezulton me me përgjegjësi tatimore për Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatim i Mbajtur në Burim, Tatimi mbi fitimin, Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi. Po kështu, nga ana e tij është paraqitur dhe vertetimi Nr. T00389458 date 27.06.2018, në të cilin rezulton që se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën: 27.06.2018 ora 22:09:34. Për sa kohë këto dokumente janë të ndryshëm, janë paraqitur nga vete operatori ekonomik, për të vertetuar kapacitetet e tij dhe janë vete 7 min distance kohore, jo në periudhë pune nga Drejtoria perkatese e Tatim Taksave, krijojnë dyshimin që dokumentet nuk janë autentike.

Në lidhje me deshmite për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontratën e qerave me subjektin VARAKU E shpk, me afat përdorimi 24 muaj. Po ky mjet me targe DR 7405 E, i është dhënë me qera dhe subjektit COLOMBO shpk, për të njëjten periudhë kohore, ose që përfshin këtë periudhë, çfarë e bën këtë kontratë fictive dhe të pavlefshme.

Për të vertetuar kapacitetin ligjor të shoqërisë nga operatori ekonomik është paraqitur ekstrakti i gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik. Dy dokumentet e paraqitura nga mbajnë as nënshkrimin elektronik dhe as atë në hard copy.

2. Operatori ekonomik “Beqiri” shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Në lidhje me deshmite për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur mjetin me targe AA792NI, në lejen e qarkullimit të të cilit kodi i karrocërës është B2 (jo autobitumatrice). Në foton e paraqitur nuk duket targa, çfarë e bën të pamundur identifikimin e saj.

Për kapacitetin teknik “Fabrike asfaltbetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi”, operatori ekonomik Beqiri shpk ka marrë me qera impjantin nga subjekti “Spartaku shpk”, date 04.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Don Jurge shpk”, rezulton që subjekti “Spartaku shpk”, date 06.07.2018, i ka nënshkruar këtë të fundit një kontratë furnizimi, me afat 2 vjeçar çfarë verteton faktin që kontratat janë fiktive dhe të pavlefshme.

Ne kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit Vertetimi Nr. T00356452 datë, 13.06.2018, (Për pagim Detyrimesh), dhe Vertetimi Nr. T00336858 Datë, 04.06.2018 (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a), janë të panenshkuar elektronikisht dhe as në hard copy.

3 Operatori ekonomik Sterkaj shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Në licencën profesionale të shoqërisë, me Nr. NZ.1354/18, datë 13.03.2017, rezulton që për drejtuesit teknik Adrian Frroku dhe Roza Karaduni, nga të dhënat e formularit E – SIG “Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, të paraqitur nga subjekti, nuk janë paguar sigurimet shoqërore, kjo në kundërshtim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, pika 2, të DST-se, ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.

Po kështu kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c ku përcaktohet se *Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.* Dhe në vijim Kreu VII ku përcaktohet se *Shoqërisë që kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.*

Në lidhje me deshmite për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontratën e qerash me subjektin GE & CO shpk, nënshkruar me datë 23.10.2015, me afat qera 5 vite. Po ky mjet me targë TR4893L, i është dhënë me qera dhe dy subjekteve të tjera 2 T shpk dhe Eral Construction Company, për të njëjten periudhë kohore, ose që përfshin këtë periudhë, çfarë e bën fiktive dhe të pavlefshme këtë kontratë.

4. Bashkimi i Operatoreve ekonomik Vagalat shpk & Curri shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Në licencën profesionale të shoqërisë VAGALAT pjesë e këtij bashkimi, me Nr. NZ.1929/9, datë 19.11.2012, rezulton që thuhet se gjithë drejtuesit teknik Ramis Sula, Petrit Pecani, Spiro Doko dhe Njazi Muca, nga të dhënat e formularit E – SIG “Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, të paraqitur nga subjekti, nuk janë paguar sigurimet shoqërore, kjo në kundërshtim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, pika 2, të DST-se, ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.

Po kështu kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c

Formularët E-SIG 025 të paraqitur Vagalat shpk, pjesë e këtij bashkimi janë të pakonfirmuara nga organet perkatese me nenshkrim elektronik ose e hard copy.

Per të vertetuar kapacitetin ligjor të shoqërisë nga operatori ekonomik CURI shpk, është paraqitur ekstrakti i gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik. Dy dokumentet e paraqitur nuk mbajnë as nenshkrimin elektronik dhe as atë në hard copy.

Subjekti Vagalat shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dhënë në dokumentet e tenderit ku thuhet “Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme mëmbajtjeje rutine e dimerore rrugësh në një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit që prokurohet (13 127 697 leke) dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit”, në raport me përcaktimin e dhënë në pikën 2.3.12. *”Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në përpjestim dhe përputhje me punët e marra për sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.*

5. Bashkimi i Operatoreve ekonomik Alfa 2 shpk & Spektri shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Operatori ekonomik Alfa 2 shpk, pjesë e këtij bashkimi, sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë për sipër të kryej 75.6% të shërbimeve. Në kundërshtim me pikën 2.3.12 të dokumenteve të tenderit”, ky operator nuk disponon kategorinë perkatese në licencën profesionale NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Në kundërshtim me pikën 2.3.9 të dokumenteve të tenderit ku përcaktohet se “Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë çertifikatat: EN-ISO 9001:2015 ,ISO 39001 : 2012 , EN-ISO 14001:2015 ,BS OHSAS 18001:2007 ,në përputhje me punimet e marra për sipër, ky operator nuk ka paraqitur asnjë nga çertifikatat e mesiperme.

Në licencën profesionale të shoqërisë “Spekter” pjesë e këtij bashkimi, me Nr. NZ.0625/13, datë 21.02.2017, rezulton që për drejtuesin teknik Ylli Gjoni, nga të dhënat e formularit E – SIG “Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, të paraqitur nga subjekti, nuk janë paguar sigurimet shoqërore, kjo në kundërshtim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, pika 2, të DST-se, ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.

Po kështu kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c . Dhe në vijim Kreu VII ku përcaktohet se *Shoqërisë që kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet*

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik "Autobitumatriçe", në pronësi ose me qira, cope 1, nga dokumentacioni paraqitur rezulton mjeti kamion dhe jo APV (ATV).

6.Operatori ekonomik Company Riviera 2008 shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Fabrika asfaltobetoni e paraqitur nga Operatori ekonomik rezulton te jete e montuar dhe instaluar ne "Fushe Mamurras", pra ne nje vendodhje me larg se 60 km nga objekti ne kundershtrim me kriteret e dhena ne dokumenetet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë „*AGBES KONSTRUKSION*“ sh.p.k. Fier, Sheq i Madh, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 29 414 987.2 (njezet e nente milion e katerqind e katermbedhete mije e nenteqind e tetedhete e shtate pik dy) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise se Rajonit Jugor Gjirokaster , nr. telef. 084262529 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do te anulohet siç parashikohet në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.07.2018

Ankesa: Ka pasur ankesa nga operatori ekonomik "STERKAJ" sh.p.k. Ka marrë përgjigje në datë 09.08.2018.